



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Miratoi
Rektori
Prof.Dr Arben GJATA



**Rregullore e funksionimit të Njesisë të Sigurimit të Brendshëm të
Cilësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë**

Tiranë më 15 qershor 2015

Neni 1

Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në legjislacionin në fuqi, në Standardet Shtetërore të Cilësisë, në Statutin dhe Rregulloren Universitetit, Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësiren Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL), si dhe në gjithë aktet e tjera normative që kanë këtë objekt.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj rregullore është të përcaktoje procedurat dhe metodat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional dhe jo vetëm, vlerësimit të cilësisë të punës së mësimdhënësve dhe kërkimit shkencor si dhe funksionet themelore dhe marrëdhëniet reciproke të të gjithë subjekteve/njësive në progresin e vlerësimit të cilësisë në UMT.

Neni 3

Qëllimi i Vlerësimit të Brendshëm

Procesi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë ka disa qëllime kryesore:

- Përcaktimin dhe përmirësimin e metodologjive të punës për arritjen e qëllimeve dhe objektivave, politikave, procedurat, shërbimet, mjedisi organizativ dhe intelektual si dhe performanca institucionit.
- Analizimin e ndërlidhjes të procesit të mësimdhënies dhe veprimtarisë shkencore-kërkimore të institucionit;
- Vlerësimin e kapaciteteve të stafit, programit ose institucionit për përmirësim të vazhdueshëm të tij.
- Kryerjen e analizës SWOT (anë e forta dhe të dobëta, mundësitë e pengesat e institucionit), si dhe propozime rekomanduese përkatëse
- Nixitjen e pjesëmarrjes dhe angazhimit për zbatimin e rekomandimeve, nëpërmjet dhënies së propozimeve të sakta dhe të argumentuara
- Të përgatisë materiale me shkrim, që mund të përdoren si bazë e vlerësimit të jashtëm nga agjencitë e autorizuara për këtë qëllim dhe rishikimi nga individët e tjerë brenda institucionit ose sistemit më gjerë.

Neni 4

Fusha e veprimit

Fushat e veprimit të sigurimit të cilësisë, sipas prioriteteve janë:

Menaxhimi i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe njësive kryesore dhe bazë (fakultete/departamente) në shërbim të misionit të tij lidhur me autonominë, organizimin;

partneritetin; të burimeve njerëzore; veprimtarisë mësimore; financiare; sistemet e informacionit dhe kapacitetet në infrastrukture të UMT-së.

Programet e studimeve dhe procesi i mësimdhënies: ridimensionim i misionit dhe objektivave kryesore të programeve të studimeve ekzistuese apo hapja e programeve të reja të studimit në përputhje me misionin dhe vizionin e UMT-së; rishikimi periodik i programeve ekzistuese dhe përditësimi i syllabuseve përkatëse në funksion të zhvillimeve të reja shkencore dhe teknologjike në fusha përkatëse, si dhe në funksion të tregut të punës; vlerësimi i performancës nga studentët për disa aspekte kryesore; vlerësimi i performancës së lektorëve nga përgjegjësi i njësisë kryesore; rezultatet e kërkimit, përhapja, përfshirja e studentëve në kërkim, si dhe transferimi i tyre.

Neni 5

Subjektet e vlerësimit të cilësisë

Subjekte të vlerësimit të cilësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë janë grupet e interesit si: stafi akademik, ndihmës akademik dhe administrativ; studentët potenciale, aktuale dhe alumni, punëdhënësit e mundshëm të të diplomuarve; njësitë përbërëse të strukturës organizative akademike dhe administrative të UMT-së etj.

Neni 6

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila ngrihet me Vendim të Senatit Akademik të UMT-së, është organ kolegjal me një mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. NJSBC ka për detyrë të kryejë vlerësimin dhe raportimin periodik sipas fushave të veprimit të sigurimit të cilësisë të përcaktuara në aktet normative në fuqi (në tërësi apo specifikisht) në përputhje me standardet e cilësisë. NJSBC ka akses të plotë në grumbullimin e të dhënave drejtpërdrejt në njësitë kryesore të UMT, apo nëpërmjet organizimit të vlerësimit periodik sipas fushave të veprimit të sigurimit të cilësisë. Rezultatet/analizat e nxjerra, NJSBC i raporton në mënyrë indirekte nëpërmjet zv. Rektorit (për anën mësimore) autoritetit më të lartë drejtues në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Neni 7

Përbërja dhe funksionet e NJSBC

Përbërja e NJSBC është sipas përcaktimeve në Statutin e UMT.

Funksionet e NJSBC, me qëllim konsolidimin e kulturës së cilësisë në UMT në përputhje me kërkesat kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë janë rol mbështetës: ofron dhe siguron takime/trajnime dhe me ekspertë të fushës për sigurimin e cilësisë me grupet e interesit UMT, krijon bazën dokumentare si udhëzime, pyetësorë vlerësimi etj; rol administrativ: administron, mbledh dhe përpunon informacione, harton analiza/raporte bazuar në procese dhe rezultate, evidenton çështje dhe jep rekomandime përkatëse; rol bashkërendues: bashkërendon proceset e

vlerësimin të cilësisë kur procesi kryhet në nivel horizontal në njësi akademike apo administrative të njërive kryesore të UMT-së; NJBSC-ja mund të koordinojë proceset e vlerësimit të organizuar prej saj në fakultete, departamente dhe njësitë e tjera janë të përfshira në rrjetin e sigurimit të cilësisë, p.sh. grumbullimi i të dhënave apo analizave; NJBSC-ja rregullisht fton çdo fakultet dhe çdo departament për të zhvilluar kërkime për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Në veçanti, kërkimet, duhet të evoluojnë rreth zhvillimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë, duke vlerësuar përdorimin e mësimdhënies moderne, të mësuarit dhe metodat e vlerësimit të studentëve, me qëllim për të promovuar një qasje interaktive me studentin në qendër.

Neni 8 **Përgjegjësitë**

NJSBC planifikon të gjitha aktivitetet lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Bën mbledhjen e të dhënave sipas treguesve sasiore dhe cilësore për institucionin dhe programet e studimit. Organizon vlerësimin e vazhdueshëm periodik në të gjitha fushat apo specifike të sigurimit të cilësisë. Krijon një sistem dokumentacioni për sigurimin e cilësisë duke përditësuar procedurat të ndryshme në funksion të sigurimit të cilësisë, formularë tip etj. Drejton objektivat për të maksimizuar përfitimet nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë, përmirëson metodologjitë e punës për arritjen e qëllimeve dhe objektivave.

Monitoron zbatimin efektiv dhe bën rivlerësimin e politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, regjistron, analizon dhe jep informacion statistikor duke ruajtur pavarësinë operative.

Udhëzon kordinatorin e njësisë kryesore për përgatitjen e raporteve të vlerësimit, për programet dhe veprimtaritë që mbulojnë. Bën vlerësime për stafin akademik duke filluar me ankëtimet/pyetësorët e studentëve, merr në konsideratë vlerësimin/et e performancës së lëktorëve mbi mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe mbështetjen administrative në njësinë përkatëse, bën përpunimin e pyetësorëve institucionale, nxit pjesëmarrjen dhe angazhimin për zbatimin e rekomandimeve nëpërmjet plan veprimeve të detajuara dhe të argumentuara.

Rrit ndërgjegjesimin në grupet e interesit për sigurimin brendshëm të cilësisë në UMT. Bashkërendon dhe asiston procesin e vlerësimit të brendshëm në të gjitha nivelet: në nivel universiteti, nivel njësie kryesore dhe nivel njësie bazë.

Auditon dhe vlerëson praktikat/procedurat e ndjekura nga njësitë kryesore dhe/ose te universitetit sipas sistemit dhe mekanizmit të krijuar nga institucioni, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet në bazë të treguesve të të gjithë komponenteve të cilësisë, në bazë të kriterëve dhe standardeve të përcaktuara. Merr pjesë në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (grupe ad-hoc) që ngrihen nga titullari i Institucionit, për përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm;

Ruan njohuritë teknike dhe profesionale duke marrë pjesë në programet e trajnimit dhe në takimet që lidhen me cilësinë në arsimin e lartë në ëorkshop-e edukuese.

Bashkëpunon me institucionet e sigurimit të jashtëm të cilësisë për procesin e vlerësimit dhe akreditimit.

Bashkëpunon me NjSBC-të e institucioneve të tjera të arsimit të lartë, për të shkëmbyer përvojën.

NjSBC kryen peridikisht çdo 2 vite akademike harton Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe i cili i përcillet titullarit të institucionit dhe Senatit Akademik.

Neni 9

Format e monitorimit i sigurimit të cilësisë

Për të menaxhuar/monitoruar sigurimin e cilësisë nevojitet hartimi i proceseve me instrumentat/mekanizmat përkatës, për analizimin e rezultateve, formulimin e rekomandimeve dhe diskutimin e tyre në organizime të ndryshme (departamente, fakultetet e universitet, duke përfshire organet drejtuese). Monitorimi i sistemit kontrollues-rregullator, duke u bazuar në rezultatet/përfundimet në plan zhvillimi vjetor sipas Planit të Zhvillimit Strategjik të UMT-së.

Neni 10

Komunikimi i procesit të vlerësimit

Fillimi i procesi i vlerësimit të cilësisë i komunikohet të gjithë njëjësive që do të vlerësohen që në momentin e fillimit të tij.

Neni 11

Metodat dhe mekanizmat e vlerësimit dhe të rivlerësimit të brendshëm të cilësisë

Metodat e vlerësimit dhe të rivlerësimit të cilësisë bazohen në: Rishikimi vetë-rregullator; Analiza e informacionit statistikor dhe/ose përdorimi i treguesve të performancës të krahasimit të praktikave me të mira; Ankëtime të studentëve, të diplomuarve/alumni, punonjësve;

Mekanizmat kryesore të matjes në bazë të të cilave institucioni kryen vetëvlerësimin janë:

1. Të dhënat e mbledhura nga mekanizmat e reagimit, grupet e vlerësimit; puna në ekip e orientuar drejt diskutimeve - "rathët e cilësisë"; rishikuesit vetërregullatorë (të jashtëm dhe të brendshëm); grupet e interesit, intervista individuale etj;
2. Të dhëna statistikore të disponueshme në njësitë përbërëse të universitetit, që janë treguesit kyc të performancës (TKP) (të dhëna për nivelin e suksesit të studentëve, studentët që regjistrohen dhe që përfundojnë studimet brenda kohëzgjatjes normale të studimit, numri i stafit akademik, alokimet e buxhetit dhe elemente të ngjashëm);

3. Rezultate dhe të dhëna të tjera dokumentuese (teza provimesh dhe përgjigjet përkatëse, publikimesh, vëzhgime të procesit mësimor dhe elementë të ngjashëm), ku këto të dhëna i vihen në dispozicion titullarëve njësive përkatëse.

Neni 12

Pyetësoret e studentëve

Pyetësorët e studentëve dhe stafit janë forma më përdorshme për realizimin e proceseve të sigurimit të cilësisë, por jo i vetmi. Ato përgatiten nga grupe të posacme dhe të dhënat e përpunara, pasi janë diskutuar me grupet e synuara, iu vihen në dispozicion organeve drejtuese.

Pyetësoret duhet:

- të bëjnë pyetje që janë të rëndësishme për identifikimin e dhënies efektive të mësimit, pa krijuar paragjykime;
- të kenë një numër të kufizuar pyetjesh dhe të lejojnë dhe dhënien e mendimeve specifike të tyre;
- nëpërmjet pyetjeve, studentët duhet të shprehin thjesht dhe qartë angazhimin e tyre në procesin e të nxënimit, me qëllim që t'i transmetojnë atyre se të dhënit dhe të nxënimit e mirë të mësimit është rezultat i një partneriteti aktiv midis pedagogut dhe studentit; të ofrojnë komente për studentet, të trajtojnë metodat që përdorin pedagogët për të arritur rezultatet e të nxënimit të përcaktuara në një lëndë/disiplinë të caktuar etj, apo se çfarë është ndryshuar mbi bazën e rezultateve të pyetësorëve.

Neni 13

Të dhënat statistikore dhe treguesit kyc të performancës (TKP)

Universiteti disponon të dhënat, që përfshijnë elemente të tillë si: nivelet e kalueshmërisë, nivelet e diplomimit, diversiteti i profileve të studentëve, ndërkombëtarizimi etj. Këto të dhëna zakonisht mblidhen në nivel fakulteti dhe i dërgohen NJSBC e cila bën dhe analizën e tyre, që përfshijnë por nuk kufizohen në:

- Ecurinë e studentëve dhe nivelet e suksesit
- Mundësitë e punësimit të të diplomuarve
- Profilin e popullsisë studentore
- Raportin staf akademik/studentë
- Efektivitetin e stafit akademik
- Monitorimin e situatës së punësimit të të diplomuarve
- Nivelin e largimit të studentëve nga shkolla
- Numrin i stafit dhe studentëve që emërohet dhe largohet.

Neni 14

Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit

Cilësia e programeve studimore realizohet nëpërmjet krijimit dhe përgatitjes së standardeve të posacme dhe modaliteteve të përshtatshëm. Institucioni duhet të monitorojë rregullisht (në një

cikël të rënë dakord) efektivitetin e programeve të tyre. Aktiviteti i monitorimit rutinë që do të jetë shpesh përgjegjësi e personave që vlerësojnë performancën e tyre në fund të cdo viti akademik, mund të shqyrtojë, për shembull, por jo vetëm:

- raportet e vlerësuesve të jashtëm
- raportet nga organe akredituese ose organe të tjera të jashtme
- komente nga stafi akademik dhe studentët
- komente nga ish studente dhe punonjës të tyre
- progresi i studentëve dhe të dhëna të tjera përkatëse
- materiale në dispozicion të studentëve, si për shembull specifikime programesh, faqe interneti.

Neni 15

Vlerësimi i cilësisë së procesit mësimor sigurohet nëpërmjet

- a) Organizimit, përgatitjes dhe ndarjes së procesit mësimor në atë mënyrë që studenti:
 - Të zhvillojë aftësitë komunikuese dhe interaktive;
 - Të aplikojë koncepte teorike themelore;
 - Të zhvillojë aftësitë të cilat do ti mundësojnë studentit që pavarësisht se mund të punojë por dhe të arrijë të kërkojë njohuri të reja;
 - Të ketë përgjegjshmërinë nëse është anëtar në një ekip;
 - Të zhvillojë aftësitë e mendimit dhe të zgjidhjes së problemeve;
 - Të zhvillojë aftësitë e integritetit të njohurive.
- b) Sigurimit të cilësisë të stafit akademik dhe joakademik,
- c) Sigurimit të raporteve profesionale në punë me studentë
- d) Sigurimin e kushteve të përshtatshme për punën kërkimore-shkencore dhe përsosshmërinë e dhënies së mësimi;
- e) Sigurimit të numrit të nevojshëm të lektorëve me kohë të plotë dhe të ftuar,
- f) Sigurimin e kapacitetve infrastrukturore në funksion të procesit mësimdhënës dhe jo vetëm
- g) Sigurimin e literaturës bazë dhe asaj të këshilluar, në bibliotekë si dhe të gjithë hapësirës së mjaftueshme në to.

Neni 16

Vlerësimi i punës akademike dhe kërkimore-shkencore

Me qëllim sigurimin e cilësisë së punës kërkimore-shkencore dhe akademike, si dhe me qëllim të unifikimit në universitet, organet kompetente të UMT-së, si edhe gjithë personeli akademik, pandërprerë angazhohen në krijimin, përgatitjen dhe realizimin e programit të studimit, shkencor dhe projektet kërkimore, në përputhje me:

- Strategjinë dhe politikën e UMT-së;
- Nevojat dhe pritshmëritë e shoqërisë;
- Praktikën më të mirë të institucioneve të huaja arsimore dhe kërkimore-shkencore;

- Nevojat për sigurimin e cilësisë në fushat e tjera të UMT-së në të cilat kjo rregullore është e zbatueshme;
- Disponimin e burimeve të brendshme dhe të jashtme për realizimin e programeve dhe projekteve konform standarteve.

Neni 17

Treguesit për vlerësimin e punës kërkimore-shkencore

Veprimtaria kërkimore-shkencore vlerësohet sipas standardeve të mëposhtme:

- Numri i publikimeve;
- Numri i projekteve të aplikuara (kombëtare dhe ndërkombëtare);
- Numrit i projekteve të realizuara (kombëtare dhe ndërkombëtare);
- Pjesëmarrjet në seminare, konferenca, këshilla shkencor, borde editorial (kombëtare dhe ndërkombëtare)
- Numrit i pjesëmarrjeve në trajnime, aktiviteteve shkencore (kombëtare dhe ndërkombëtare).

Neni 18

Masat për përmirësimin e cilësisë në UMT

Rektori dhe Senati Akademik në bazë të Raportit periodik të NJSBC për vlerësimin institucional të cilësisë, propozon dhe harton planveprimin për përmirësimin e mëtejshëm të sigurimit të cilësisë, miratimi dhe rishikimi i kurrikulave që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, bëhet në nivel fakulteti dhe departamenti, si dhe monitorohet nga njësia përgjegjëse të sigurimit të brendshëm të cilësisë të fakultetit.

Për hartimin, miratimin dhe rishikimin e një programi studimi, përveç stafit akademik të njësisë përgjegjëse, rekomandohet të ketë:

- ✓ Eksperte të jashtëm që ofrojnë informacione dhe orientime perkatëse mbi zhvillimet aktuale të programit
- ✓ Partnerë program nga institucione me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi (ne rast se ka)
- ✓ Studentë që studiojnë aktualisht në program (kryesisht të viteve të larta)
- ✓ Të diplomuar nga programi
- ✓ Shoqata/Urdhrat përkatës profesioanle
- ✓ Burime dhe ekspertë të jashtëm që ofrojnë informacion përkatës dhe orientime për tregun e punës ku gjen zbatim program

Nevoja për rishikim/përmirësim të programeve të studimit vjen si pasojë e monitorimit periodik të efektivitetit të programeve/it të studimit. Aktiviteti i monitorimit periodik, e cila kryhet në nivel departamenti dhe fakulteti, mund të shqyrtojë:

- ✓ Raporte të vlerësimit të jashtëm për programin/et
- ✓ Komente/sugjerime/propozime nga stafi akademik dhe studentët (pyetësorë, takime, tavolina të rrumbullakëta etj)
- ✓ Komente/sugjerime/propozime nga ish student dhe punëdhënësit e tyre

✓ Progresi/përfomanca e studentëve dhe të dhënat lidhur me to
Për hartimin, miratimin dhe rishikimin e programeve është e rëndësishme të merren në konsideratë:

- ✓ perputhshmeria e propozimeve të programeve dhe zhvillimeve me qëllimet dhe misionin institucional të përcaktuara në Strategjinë e zhvillimit të UMT-së
- ✓ pika të jashtme referencë, standarde akademike, kërkesat statutores dhe rregullatore,
- ✓ planifikimi i burimeve akademike, administrative dhe infrastrukturore
- ✓ kapacitetet ekzistuese brenda institucionit, duke përfshirë çdo njohje që mund të ofrohet bashkërisht me institucionet shqiptare ose të huaja;
- ✓ niveli i rrishtit të përfshirë në çdo proces hartimi, miratimi apo rishikimi i programeve dhe niveli optimal i burimeve të nevojshme për të garantuar arritjen e rezultateve të kërkuara të procesit.

Neni 19

Interpretimi

Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik dhe nënshkruhet nga ana e Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.